



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIJË DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 3334/11 Prot.

Tiranë, më 26.05.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Kërkim Zbulimit Nr.1805/2, datë 29.01.2020.

SHOQËRISË “TUR-ALB-KROM” SH.P.K  
RRUGA “SKENDERAJ”, LAGJIA NR.3, PALLATI FLY, KATI 7,  
DURRËS.

Për dijëni: **SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR**  
Rruga “Myslim Keta”, Ish Instituti Gjeografik Shqiptar, Tiranë.

TIRANË

Shoqëria “TUR-ALB-KROM” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të kërkim - zbulimit nr.1805 datë 08.06.2016, për mineral kromi, në objektin “Malzi-Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Leja juaj është dhënë si leje zbulimi nr.1805, datë 08.06.2016, për mineral kromi për një sipërfaqe 1.759 km<sup>2</sup>, në zbatim të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2011 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në nenin 14 pika 1 dhe 2, të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me shkresën e Ministrit nr.1163, Prot, datë 29.01.2020 jeni pajisur me leje minerare kërkim zbulimi Nr.1805/2 datë 29.01.2020, shtyrje afati njëvjeçar të lejes minerare të kërkim zbulimit Nr.1805, datë 08.06.2016, për minerali kromi, objekti “Malzi-Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën Nr.442, datë 08.04.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3334, Prot, datë 12.04.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Minerare të Kërkim Zbulimit Nr.1805/2 datë 29.01.2020, për mineralin Krom, në objektin “Malzi-Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Bazuar në informacionet e arritura nga shoqëria “Tur-Alb-Krom”sh.p.k, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, monitorimet e kryera në terren nga specialistet e Drejtorisë së Burimeve Minerale, për periudhën një vjeçare të shtyrjes së afatit(periudha 29.01.2020-29.01.2021), rezulton se shoqëria nuk ka realizuar volumet fizike dhe investimet e miratuara, për lejen minerare të kërkim zbulimit nr.1805/2, datë 29.01.2020, që zotëroni, **duke dështuar në realizimin e programit minimal të punës** si dhe afati i vlefshmërisë së lejes së kërkim – zbulimit nr.1805/2, datë 29.01.2020, ka përfunduar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 47, pika 1, germa “ë”, të Ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr. 1805/2, datë 29.01.2020, për mineral kromi, objekti “Malzi-Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.**

**Ju bëjmë me dije se brenda një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare ne fjalë.**

Ne zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ILIR BEJTJA**

